



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 5642

Nr.5617Vendimi

NR. VENDIMI 5617

V E N D I M
“ NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë e përbërë prej:

ILIR ÇELIKU – GJYQTAR

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela Marashi** në datën 28.06.2016mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile me Nr. **5642 Akti**, që iu përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS:

***** sh.p.k. me seli në ***, përfaqësuar në gjykim me autorizim datë *** nga Av. *** dhe Av. ***.**

I PADITUR :

***** person Fizik me Nipt *** me adrese, *****

PERSON I TRETE:

Drejtoria e Pergjithshme e Patentave dhe Markave, perfaqesuar me autorizim dt 23.06.2016 nga znj. ***

OBJEKT:

- 1.Konstatimin e konkurrencës së pandershme nepermjet perdorimit te paautorizuar te markes tregtare ZGARA KORCARE.**
- 2.Ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregtare ZGARA KORCARE ne qarkullimin tregtar nga pala e paditur.**
- 3.Shperblimin e demit te shkaktuar nga perdorimi i paautorizuar i markes tregtare ZGARA KORCARE**
- 4.Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te pales se paditur.**

BAZA LIGJORE :

Neni 348 te K.Pr.Civile, Neni 638,639 e ne vijim i K.Civil, Ligji nr.9947 date 07.07.2008 “Per pronesine Industriale”, neni 156 e ne vijim.

Gjykata,

- si dëgjoi palën paditëse që gjatë gjykimit dhe në përfundim të tij kërkoi *pranimin e padisë*;
- zhvilloi *gjykimin në mungesë* të palës së paditur dhe të personit të tretë;
- Administroi provat e paraqitura dhe si shqyrtoi në tërësi çështjen;

V Ë R E N

Pala paditëse Shoqëria “****” sh.p.k është një shoqëri e së drejtës shqipëtare dhe e ushtron veprimtarinë e distribucionit dhe eksport-import te artikujve te ndryshëm ushqimore, industriale, pijeve alkalike, publikim i mediave te shkruara, revista te ndryshme.

Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe për nevoja të aktivitetit tregtar, Shoqëria “****” sh.p.k ka regjistruar Markën Tregtare “ZGARA KORÇARE” në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave me datë depozitimi 17 Dhjetor 2012, me numër regjistrimi kombëtar ***, datë rregjistrimi 28 Qershor 2013.

Nëpërmjet kërkesë-padisë së paraqitur pala paditëse ka parashtruar se pas regjistrimit të markës tregtare në pronësi të saj është vënë në dijeni prej disa muajsh për përdorimin e markës tregtare “ZGARA KORÇARE” në territorin shqiptar nga subjekte të paautorizuar prej saj.

Një ndër këto subjekte sipas palës paditëse është aktiviteti që ushtron i padituri *** i cili sipas ekstraktit të QKR datë 29.02.2016 rezulton i regjistruar si Person Fizik (tregtar) me Nipt *** me objekt veprimtarie “Bar-Restorant” dhe emër tregtar “ZGARA Korcare”, por sipas palës paditëse në vendin e aktivitetit të tij ka afishuar tabelën “ZGARA KORÇARE” që është njëkohësisht marka tregtare në pronësi të palës paditëse.

Në datën 24 Nëntor 2015 shoqëria “**** ” sh.p.k, i është drejtuar palës së paditur *** duke kërkuar ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës “ZGARA KORÇARE” në qarkullimin tregtar, si mbajtës i së drejtës për markën tregtare duke i lënë një afat 30 ditor për njoftimin e pushimit të cënimit, por pala paditëse nuk ka kryer asnjë veprim në këtë drejtim.

Në kushtet e mos reagimit dhe marrjes së masave nga ana e palës së paditur e cila megjithëse është vënë në dijeni për markën në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k,pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur ka vazhduar me përdorimin e markës në qarkullimin tregtar, dhe për rrjedhojë pala paditëse i është drejtuar Gjykatës me padinë për shqyrtim për konstatimin e për shkeljen e të drejtave mbi markën në pronësi të shoqërisë “**** ” sh.p.k në përputhje me Ligjin nr.9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” , kapitullit XXVII nenit 167 “Ushtrimi i të drejtave”me këtë përmbajtje:

Neni 167

“1.Aplikanti, pronari i markës së regjistruar, personi i licencuar, përdoruesi i autorizuar i një marke kolektive ose çdo person tjetër, të drejtat e të cilit, të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, shkelen, mund të ngrenë padi në gjykatë kundër shkeljes së të drejtave. Për qëllim të këtij kapitulli, pronarët e markave, që janë të mirënjohura në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën “ç” të

pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji, gëzojnë të njëjtat të drejta, që gëzojnë pronarët e markave të regjistruara.

2. Çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, përbëjnë shkelje të së drejtës së markës së regjistruar ose të një marke, për të cilën është paraqitur një aplikim për regjistrim, sipas ligjit.

3. Personi, sipas kuptimit të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tij, për të kërkuar:

a) ndalimin e veprimeve të tjera në shkelje të të drejtave;

b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave, nga qarkullimi civil ose, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e këtyre objekteve;

c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht për krijimin ose prodhimin e produkteve që përbëjnë shkelje apo, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e tyre;

ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, në mënyrën e parashikuar nga gjykata.

4. Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe dhe mund, sipas rastit:

a) të marrë parasysh të gjitha aspektet përkatëse, siç janë pasojat negative ekonomike, përfshirë fitimet e munguara, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi dhe, sipas rastit, elemente të tjera përveç faktorëve ekonomikë, si dëmi moral, që i është shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja;

b) të vendosë kompensimin e dëmeve me shuma të menjëhershme, në bazë të elementeve, si shuma e të ardhurave ose tarifave, që do të siguroheshin apo merreshin, në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë intelektuale në fjalë.

5. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data, kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin”.

Gjatë gjykimit të çështjes pala e paditur *** nuk mori pjesë në gjykim megjithëse për seancën pregatitore të datës 15.02.2016 me fletëthirrje nuk mori dijeni pasi u kthye me shenimin larguar nga kjo adrese, gjykata e njoftoj me shpallje, por nuk mori pjesë në proces, për rrjedhojë gjykimi u zhvillua në mungesë të palës së paditur.

Gjykata

Në analizë të pretendimeve të palëve dhe provave të paraqitura, gjykata çmon se padia e ngritur është e bazuar në prova dhe ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

Sa i përket *legjitimitit aktiv* (*ratione personae*). Pala paditëse është pronare e ligjshme, e çertifikuar e markës tregtare “ZGARA KORÇARE”, regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave me datë depozitimi 17 Dhjetor 2012, me numër regjistrimi kombëtar ***, datë rregjistrimi 28 Qershor 2013. Marka tregtare përfaqëson një nga format e

pronësisë industriale dhe në interpretim të normave ligjore në fuqi dhe të detyrueshme për zbatim gjykata sqaron se me termin pronë do të kuptohen një sërë interesash ekonomike në funksion të qëllimit të të drejtës së pronës, duke përfshirë për këtë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, interesat pasurore dhe jo pasurore. Pala paditëse në cilësinë e pronarit të kësaj marke tregtare legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me padi të paraqitur proceduralisht në gjykatën kompetente, formalisht të rregullt, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë mbi markën tregtare.

Për sa i përket *legjitimit pasiv* padia i kundersdrejtohet mbajtësit të së drejtës së pretenduar. I padituri *** rezulton të jetë përdorues i markës tregtare “ZGARA KORÇARE”. Ai ka vendosur tabelën me të njëjtin emër në vendin ku ushtron veprimtarinë e tij. Megjithëse pala paditëse i është drejtuar me shkresë të paditurit për ndalimin e përdorimit të saj, pala e paditur nuk i ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk ka marrë asnjë masë për ndalimin e cënimit të markës. Nga pamjet, foto të paraqitura nga pala padiëse shihet vendosja e tabelës “ZGARA KORÇARE”, në adresën që sipas edhe ekstraktit të QKR është adresa e vendit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga i padituri ***.

Duke ju referuar ligjit nr.9947 “Për Pronësinë Industriale” datë 07.07.2008 neni 156 veprimi i kryer nga ana e palës së paditur bie në kundërshtim me ligjin pasi vetëm pronari i markës së regjistruar ka të drejtën ekskluzive të përdorimit të saj.

Paditësi legjitimohet ***ratione temporis***, pasi padia është paraqitur brenda afatit ligjor tre vjeçar e parashikuar në nenin 167 pika 5 të ligjit.9947 “Për Pronësinë Industriale” datë 07.07.2008 sipas të cilit “*Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin*”.

Lidhur me themelin e kërimit.

Gjatë e hetimit gjyqësor rezultoi e provuar se pala paditëse është pronar i regjistrimit për markën “**ZGARA KORÇARE**” (**fjalë te stilizuara– e zezë, e bardhë, kafe dhe nuancat e saj**) e regjistruar në regjistrin e Markave dhe Patentave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave prej 28 Qershor 2013 ndërmjet një regjistrimi kombëtar dhe mban Nr. *** e regjistruar në Klasën 43 (Restorante), të Klasifikimit të Nicës .

Marka e regjistruar nga pala paditëse dhe marka tregtare e vendosur nga pala e paditur në ambjentin ku ushtron veprimtari tregtare janë fontetikiisht identike, shenjat janë ekstremisht të ngjashme. Fjalët janë të stilizuara në të njëjtën mënyrë; kanë të njëjtën strukturë, dhe kanë të njëjtin kuptim leksikologjik. Gjithashtu vendosja e fjalëve, kuptimi dhe informacioni që ato përcjellin janë identike. Kjo lloj ngjashmërie përbën burim konfuzioni tek konsumatori në lidhje me markën tregtare, dhe me produktet dhe cilësitë që përfaqëson.

Në Ligjin Nr.9947 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” neni 140 “*Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që **shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik**, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të*

këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme:

a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.

Duke ju referuar kësaj dispozite, marka tregtare e regjistruar është e paraqitur grafikisht, përmban elementët thelbësorë me karakter dallues për të diferencuar dhe arritur tek konsumatori me synimin që ky i fundit të mund të dallojë këtë markë nga një tjetër. Marka ZGARA KORÇARE (fjalë dhe element stilizuar) me numër Rregjistrimi nacional *** me datë rregjistrimi 17 Dhjetor 2012, është rregjistruar është në përputhje me pikën 1, 2 (a,d) të nenit 140 si dhe pikës 3 të tij pasi është paraqitur në formë grafike, si fjale dhe kombinim ngjyrash. Qëllimi i markës tregtare është krijimi i një përjasjeje të konsumatorit ose me saktë lidhja që vjen midis markës dhe produktit që ai tregon e përkthyer me pas në reputacion të saj në qarkullimin tregtar.

Mallrat që ofrohen nga palët ndërgjyqëse janë të njëjta dhe në këto kushte sjellin konfuzion tek konsumatori. I padituri *** rezulton të jetë përdorues i paautorizuar i Markës tregtare “ZGARA KORÇARE”, gjë që rezulton si nga fakti se megjithëse pala paditëse i është drejtuar me shkresë për ndalimin e përdorimit të saj dhe pala e paditur nuk i ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk ka pasur asnjë reagim tjetër ashtu edhe nga pamjet , fotot të paraqitura nga pala paditëse ku shihet vendosja e tabelës në adresën që sipas edhe ekstraktit të QKR është adresa e vendit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga i padituri *** Pra, pala e paditur e ka përdorur dhe vijon ta përdorë markën sa kohë që tregon të njëjtin shërbim sikundër dëshmohet nga fotot e administruara në cilësinë e provës dhe megjithëse është në dijeni për pronësinë e kësaj marke, vijon ta përdorë në aktivitetin në treg pavarësisht faktit që nga ekstrakti i QKR-së pala e paditur ka deklaruar emërtim tregtare “ZGARA KORÇARE”.

Në nenin 638 të Kodit Civil parashikohet se: “Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shenjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës se pandershme kryhen prej cilitdo që:

1. Përdorë emrat ose shenjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shenjat të përdorura ligjërisht nga të tjerë ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti.
2. Përdorë vetë drejtpërdrejt ose tërthorazi cdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmerisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se pala e paditur ka përdorur markën

nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit tregtar dhe reklamimit të markës në pronësi të palës paditëse në këto kushte duke ju referuar nenit 638 të Kodit Civil, pala e paditur ka shkelur të drejtat mbi markën “ZGARA KORÇARE”, markë e mbrojtur ligjërisht efektet e së cilës fillojnë që në datë 17 Dhjetor 2012 datë e cila sjell të drejtat për palën paditëse.

Nenit 10 bis pika 3 Konventa e Parisit 1883 detyron vëndet anëtare të ndalojnë të gjitha veprimet që bien ndesh me praktika tregtare të tilla sa konfuzioni merret i mirëqënë ,gjendje kjo që krijon mbrojtje të gjerë përshhirë markën tregtare, shenjat dalluese, etiketat, hfaqjet ambalazhuese, formë ose ngjyrë të mallrave ,apo çdo tregues tjetër të mallrave që përdoret nga një biznesmen.

Në kushtet e mësipërme, gjykata konstaton kryerjen e veprimeve që cënojnë të drejtat e pronësisë mbi markën tregtare “ZGARA KORÇARE” nga i padituri dhe në përputhje me nenin 167 pika “b” të ligjit Nr.9947 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” urdhëron ndalimin e veprimeve të tjera në shkelje të të drejtave;dhe heqjen ose bllokimin e objekteve (tabelave) , që përbëjnë shkelje të të drejtave të markës tregtare.

Pala paditëse ka kërkuar në objektin e padisë edhe një vlerë si dëmshpërblim për dëmin jo pasurorë *** lekë të ardhur si pasojë e përdorimit të pautorizuar dhe shkeljen e së drejtës mbi markën dhe konkurrencën e pandershme. Ky kërkim gjen mbështetje në ligjin e poasçëm nenet 184/b dhe nenin 184/c dhe në dispozitat e Kodit Civil, nenet 608, 625 ashtu edhe praktikën Unifikuese të Gjykatës së Lartë, sipas Vendimit Nr.12, datë 14.09.2007 ku cilësohet se: “ Në gjykimet me objekt detyrimet që rrjedhin nga shkaktimit të dëmit nëse paditësi kërkon dëmshpërblimin “për të gjitha dëmet”apo “për të gjitha dëmet pasurore dhe jo pasurore”, kjo mënyrë përbën disponimin e tij për kërkimin e dëmshpërblimit për cdo figurë të dëmit pasuror ose jo pasuror”.

Nga provat dhe debati i zhvilluar në procesin gjyqësor rezulton e provuar lidhja shkakësore materiale ndermjet sjelljes së paligjshme (veprimit a mosveprimit) e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Personi përgjegjës në rastin konkret është subjekti i paditur , personi fizik tregtar *** i cili me veprimet e tij të paligjshme, duke reklamuar dhe përdorur emrat ose shenjat dalluese “ZGARA KORÇARE” tregton mallra të njëjtë me palën paditëse, i cili është mbajtësi i së drejtës për Markën Tregtare “ZGARA KORÇARE”, duke krijuar konfuzion tek konsumatori. Këto veprime konsiderohen të kryera me faj, pasi siç është konstatuar në proces i padituri ka pasur vullnetin për të përfituar ekonomikisht duke e reklamuar markën tregtare të mbrojtur në ambientet e aktivitetit të tij tregëtar dhe nuk ka vepruar për ta ndalur këtë as pasi pronari i kësaj marke, “****” Shpk e ka njoftuar për të drejtat e mbrojtura mbi të. Këto veprime të të paditurit kanë sjellë si pasojë cënimin emrit të mirë tregtar “ZGARA KORÇARE” duke i sjellë dëme ekonomike pronarit të saj , shoqërisë “****” shpk.

Në nenin 184 pika 4 e ligjit nr. Nr.9947 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” , parashikohet se : “Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe”....

Pala paditëse nuk ka paraqitur pretendime për rekuperimin e pasojave eventuale ekonomike nga cënimi i të drejtave mbi markën tregtare, por ka pretenduar vetëm dëmin jopasuror në shumën *** lekë. Duke vlerësuar në tërësi rrethanat e faktit, gjykata vlerëson kryesisht sjelljen e të paditurit pas njoftimit me shkrim të palës paditëse mbi të drejtat mbi markën tregtare dhe kohëvazhdimin e cënimit të këtyre të drejtave. Mosveprimi i palës së paditur për marrjen e masave për ndalimin e përdorimit të kësaj marke tregtare passjellll cënim të markës tregtare dhe për pasojë cënimin edhe të emrit dhe reputacionit të pronarit ligjor të saj. Në këto kushte gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat çmon të caktojë një dëmshpërblim në favor të palës paditëse në shumën *** (***) lekë.

PËR KËTO ARSYE

Konform neneve 126 dhe 305 e vijues të K.Pr.Civile; Gjykata;

VENDOSI

Pranimin e pjesëshëm të kërkesë-padisë.

Ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare “ZGARA KORÇARE” në qarkullimin tregtar në vëndin ku zhvillon aktivitetin Personi Fizik *** me Nipt ***, duke urdhëruar të paditurin të heqë nga ambjentet tabelat me emërtimin “ZGARA KORÇARE”.

Detyrimin e të paditurit *** të dëmshpërblejë palën paditëse nga përdorimi i paautorizuar i markës “ZGARA KORÇARE” si dëm moral për prishjen e reputacionit në shumën *** (***) lekë.

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

Shpenzimet gjyqësore proceduriale i ngarkohen palës së paditur.

Për këtë vendim lëshohet urdhëri i ekzekutimit bashkëlidhur.

Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve afat që fillon nga e nesërmja e shpalljes. Për palën e paditur dhe personin e tretë në mungesë afati fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë më 28.06.2016.

SEKRETARE

Ornela MARASHI

GJYQ T A R

Ilir ÇELIKU

Shpenzime gjyqësore

Taksë regj. padie ***Lekë

Avokat *** Lekë